



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR
REKTORATI

Nr. 1289 Prot.

Gjirokastrë, më 09.09.2024

Lënda: Hapet thirrja për pjesëmarrje në Programin Erasmus+ me partneritetin INTERVAL, Spanjë.

UGJ hap thirrjen për shkëmbim stafi akademik dhe administrativ, në kuadër të aktiviteteve të zhvilluara nga partneriteti INTERVAL, promovuar nga IES LUIS Simarro, Valencia, Spanjë, për periudhën 20-30 nëntor 2024.

Bazuar në komunikimin me postë elektronike zyrtare me institucionin pritës, Universiteti i Gjirokastrës do të përfaqësohet me 10 pozicione që përfshijnë stafin akademik/administrativ dhe Sektorin e Marrëdhënieve me Jashtë dhe Kërkimit Shkencor si vijon:

- 5 anëtarë të stafit akademik të Njesisë bazë Matematikë-Informatikë;
- 1 anëtar i stafit akademik të Njesisë bazë të Infermierisë;
- 1 anëtar i stafit akademik të Njesisë bazë të Shkencave Biologjike, Mjedisore dhe të Ushqimit;
- 2 staf administrativ;
- 1 Marrëdhëniet me Jashtë dhe Kërkimi Shkencor.

Shpërndarja e granteve do të jetë si vijon:

- 3 grante për periudhën 20-30 nëntor;
- 7 grante për periudhën 20-27 nëntor.

Të interesuarit të dërgojnë në mënyrë elektronike dhe fizike, pranë Sektorit të Marrëdhënieve me Jashtë dhe Kërkimit Shkencor, brenda datës **20.09.2024**:

- kontratë pune;
- letër interesi në anglisht;
- CV të detajuar mundësisht në formatin EUROPASS CV në anglisht;
- provë / certifikatë të njohurive të gjuhës angleze minimalisht të nivelit B2;
- fotokopje të pasaportës ose kartës së identitetit.

Dokumentacioni juaj do të vlerësohet paraprakisht nga një komision AD HOC i ngritur pranë UGJ-së dhe më pas ky vlerësim do t'i përcillet palës partnere, për përzgjedhjen përfundimtare të aplikantëve.

Zv/Rektor
Prof. asoc. Merita ISARAJ

Merita Isaraj

